REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. /Br. 34236/26
Nr. i fq. / Br. st. - 12 -
Data: / Datum: 30.07.2026
VUSHTRRI - VUČITRN

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB-119/26 30.07.2026

P R O C E S V E R B A L
NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË: 25 QERSHOR 2026

Mbledhja është mbajtur në sallën e "Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe filloi në orën **10:20**
Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Behar Duraku, Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Mek Selaci, Melihate Basholli Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Ramadan Parduzi, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Edmond Hyseni, Fidan Bejta, Pllumb Maliqi, Hava Mlinaku, Isak Uka dhe Stefan Markovic.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, - Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 25 anëtarë të kuvendit, kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-pasi konstatoi kuorumin, ceku se materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës janë dorëzuar sipas afateve ligjore, andaj procedoj me rendin e punës sipas rregullores së punës së kuvendit.
Refik Maloku, anëtar i kuvendit- ngriti një shqetësim lidhur me gjendjen e bimëve të cilat janë mbjellë në park e që është katastrofale. Është gjynah prej atyre bimëve me i pa në çfarë gjendje janë mbjellë. Besoni më rrallë i mbjellim patatet në sera ose në kopshte se sa ato pisha që janë aty në parkun e qytetit. Krejt kjo është bërë me qëllim të përmbushjes së kontratës se sa që ka qenë e nevojshme. Prandaj, vlerësoj se kjo është për gjynah se si është duke vepruar komuna.
Gresa Muli, anëtare kuvendit- pasi i përshëndeti të gjithë vijoi: para se të kalojmë në rendin e ditës, kam disa pyetje që pres të marr përgjigje për to. Çështja e parë është, kanë kaluar disa muaj prej një rasti që ka ndodhur që më ka shqetësuar shumë. Jo vetëm mua, por shumë prind e shumë qytetarë të komunës së Vushtrrisë. Është çështja e rastit të ngacmimit seksual që ka ndodhur në një shkollë të Vushtrrisë, që nuk po dua me cek emra për arsye të ndryshme. E di që

komuna e Vushtrrisë, as kryetari i komunës, e as Drejtoria e Arsimit nuk kanë jap të paktën një prononcim për mendimin e tyre rreth kësaj çështje dhe çfarë masa do të ndërmarrin. Pse si Kryetar i Komunës dhe si qeverisje lokale zgjodhët të heshtni përballë një rasti kaq të ndjeshëm? Pse nuk pati një reagim publik, një qëndrim institucional apo një adresim të qartë ndaj këtij shqetësimi kaq të madh. Çështja e dytë ka të bëjë me investimet në fshatin prej nga vij, fshati Sfaraçak. Fshati Sfaraçak ka shumë familje të ardhura nga shumë vende të Vushtrrisë por edhe jashtë Vushtrrisë. Fshati ka shumë ngjyrime politike ndoshta për këtë nuk është bërë asnjë investim që nga viti 2017 por edhe më herët në pjesën e Sfaraçakut të Poshtëm përveç rrugës që është ndërtuar dhe dritave që janë bërë me vetëfinancim. Së fundi në mandatin e kaluar në tetor të vitit 2024 është marrë vendim që të bëhet një trotuar rreth 700 metra. Po bëhen gati dy vite prej që kanë ardhur kubëzat, është prishur rruga dhe ende nuk ka përfunduar ajo pjesë. Nxënësit dhe qytetarët kanë probleme kur kalojnë te ajo pjesë. Arsyetimi i Kryetarit ka qenë që nuk ka mjete të mjaftueshme por kohëve të fundit po shoh që po shpenzohet në gjëra jo shumë prioritare e ajo pjesë ka mbetë shumë keq. Ju lutem që të bëni një gjithëpërfshirje edhe nëpër fshatra, sepse seriozisht fshati Sfaraçak ka shumë nevojë për rregullim dhe për investime të tjera. Të them të drejtën, mua si anëtare e Kuvendit dhe përfaqësuese e atij fshati prej tre mandatesh, po më vjen keq edhe t'i takoj fshatarët, sepse ata më thonë se nuk po bëhet asgjë për ta. Prandaj ju kisha lutur shumë që të ndërmerrni masa konkrete në këtë drejtim. Çështja e tretë ka të bëjë me bursat për studentë. Nuk e kam lënë të tretën për nga rëndësia, sepse është shumë e rëndësishme. Pse Komuna e Vushtrrisë ende nuk e ka bërë shpalljen për bursa, ndërkohë që shumica e komunave të tjera tashmë e kanë bërë ndarjen e tyre? Cila është arsyeja e kësaj vonese dhe kur planifikoni të ndani bursat? Dhe në fund lidhur me raportin e auditorit, ku pashë se ka pasur një rast ku transferimi i një mësimdhënësi është bërë pa proces rekrutimi. Dua të di sa raste të tjera të tilla ka dhe a planifikoni t'i shmangni këto shkelje dhe të zbatoni procedura të rregullta në të ardhmen?

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit- pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit, deklaroi: kam një shqetësim jo vetëm unë, por e gjithë Vushtrria. Shqetësime ka shumë, por sot dua ta trajtoj këtë çështje në Kuvend, lidhur me situatën e FC Vushtrrisë, ku për shkak të vonesave në pagesa, lojtarët dhe kryesia kanë vendosur një afat deri më 1 korrik. Nëse deri në atë datë nuk ka ndonjë zgjidhje nga kryesia apo nga Komuna, e cila siç kam kuptuar ka pasur disa biseda me lojtarët, atëherë ekziston rreziku që klubi të shuhet plotësisht. Është e pakuptimtë që një klub me traditë dhe histori të pastër të përballet me rrezikun e shuarjes për shkak të mungesës së stabilitetit financiar. Lojtarët dhe stafi kanë dhënë maksimumin për fanellën e klubit dhe është e drejtë e tyre që obligimet financiare ndaj tyre të përmbushen në kohë. Kjo situatë kërkon angazhim të menjëhershëm nga të gjithë ata që kanë përgjegjësi dhe mundësi për të ndihmuar. Nevojitet dialog, transparencë dhe një plan konkret për tejkalimin e vështirësive financiare, në mënyrë që klubi të vazhdojë garimin dhe të ruaj traditën sportive të qytetit. Ky klub nuk është vetëm një ekip futbolli, por pjesë e identitetit sportiv dhe qytetar të qytetit tonë. Prandaj, duhet të bashkohemi për ta mbështetur dhe për të gjetur zgjidhjen e duhur para se të jetë vonë. Kisha kërkuar edhe nga komuna që, nëse ekziston mundësia të ofroi ndihmë për lojtarët dhe klubin në përgjithësi.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të pranishmit vijoi: shqetësim për ne mbetet udhëkryqi te rruga për fshatin Begaj. Fatkeqësisht kemi pasur raste të tilla dhe më herët por rasti i fundit është te familja Meniqi që e kemi pasur një humbje të jetës të një djaloshi të ri. Shqetësimet tona janë që nuk po e dimë nëse komuna është duke bërë përpjekje që kjo rrugë magjistrale të kalojë në kompetencë të komunës. Deri më tani e dimë që kjo rrugë menaxhohet nga Ministria. Sa kemi qenë pjesë e qeverisjes bashkë me Lëvizjen Vetëvendosje, i kemi bërë disa kërkesa të njëpasnjëshme që kjo rrugë magjistrale të kaloj në kompetencë të komunës, por fatkeqësisht nuk

kemi marrë aprovim për një gjë të tillë. Në bazë të disa informatave që i kemi nga komuna, ministria viteve të fundit ka pasur gatishmëri që një gjë të tillë që kjo rrugë të kalojë në kompetencë të komunës së Vushtrrisë, mirëpo nuk kemi pasur vullnet nga komuna, nuk e di nëse kjo qëndron apo jo, mirëpo informatat janë nga komuna. Andaj, ju kisha lutur kryetar, që si qeverisje komunale të ndërmerrni diçka dhe dashtë Zoti që në të ardhmen mos të kemi më raste të tilla.
Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit deklaroi: Dua t'i ngriti dy çështje që mendoj që janë të rëndësishme. E para ka të bëj me objektin e shkollës fillore "Migjeni" në Stanoc të Epërm tani që është shndërruar në çerdhe. Vitin e kaluar veç është hap çerdhja, ka mbet që Drejtoria e Arsimit të marrë numrin e fëmijëve dhe të procedohet me renovimin e objektit. Fatbardhësisht është bërë një punë e mirë. Pra, çerdhja ka filluar të funksionojë, mirëpo nga ajo që e kemi parë vitin e kaluar është rinovuar vetëm gjysma e objektit dhe gjysma tjetër e objektit ka mbetur pa renovuar. Në bazë të informatave që kam, aty është rritur numri i fëmijëve. Bëhet fjalë për fshatin Stanoc i Epërm dhe fshatrat përreth, të cilat janë zona ku popullsia vazhdon të jetojë dhe nuk ka pasur lëvizje të konsiderueshme të banorëve. Prandaj është rritur edhe numri i fëmijëve. Kisha një kërkesë për ju kryetar, a e keni në plan që pjesën e mbetur të objektit, e cila për fat të keq është në gjendje jo të mirë, ta renovoni dhe ta zgjeroni për shkak të rritjes së numrit të fëmijëve që ndjekin atë kopsht? Çështja e dytë ka të bëjë me lumin që rrjedh nga Breznica, kalon nëpër Stanoc të Epërm dhe derdhet në lumin Llap. Kanalizimi përgjatë atij segmenti është i dëmtuar. Gjatë verës, kur temperaturat janë të larta, ai kundërmon dhe paraqet rrezik për shëndetin e qytetarëve. Prandaj do të kërkoja që të hartohet një projekt i ri dhe të bëhet sanimi, përkatësisht rregullimi i atij kanalizimi, sepse gjendja vërtet është e keqe.
Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit- unë kam tri çështje që dua t'i ngre. E para është për dy rrugë në Stanoc të Poshtëm, të cilat janë përgatitur për asfaltim por ende nuk është shtruar asfalti. Aty është krijuar një gjendje e tmerrshme për shkak të pluhurit. E dyta është kanalizimi që vjen nga Stanoci i Epërm. Ai tashmë është bllokuar dhe po del tek lapidari i dëshmorit Nazmi Zhegrova. Është mbushur ajo pjesë dhe fatkeqësisht edhe te shtëpia e Shukri Klunes është bërë problem i madh me kanalizimin. E treta, për drejtorin e Shërbimeve Publike kam një kërkesë edhe pse e di që ajo pronë është e ministrisë, pra ish-Enti i Punësimit. Aty qytetarët kanë ngritur shqetësime për gjendjen e rënduar. Nëse do të kishte mundësi, kërkoj nga drejtori që të angazhohen punëtorët e Ndërmarrjes Publike "Përparimi" për pastrimin e oborrit të atij objekti, sepse gjendja është vërtet e rëndë.
Fakete Dushi, anëtare e kuvendit- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit deklaroi: Kam dy shqetësime. Bëhet fjalë për banorët te varrezat. Është fjala për lagjen "Bekim Zenuni" e cila është në gjendje të rëndë. Në këtë zonë është hap një gropë shumë e madhe, zonë kjo e cila gjatë verës ka frekuentim të madh të njerëzve. Gjithashtu edhe te rruga "Isak Halili", pjesa te varrezat ka mbetur një pjesë e rrugës në zhavor. Është bërë vështirë e kalueshme sidomos kur ka reshje. Dua të ngiti edhe një shqetësim tjetër të banorëve në fshatin Sllatinë, tek ura, në pjesën e sipërme, është dëmtuar rruga dhe është krijuar një gropë shumë e madhe aty. Para dy apo tre javësh, ose rreth një muaji, veç Zoti ka dashtë që të mos bëhet një aksident shumë i rëndë. Qytetarët po kanë vështirësi në qarkullim.
Betim Grabanica, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi: Kam vetëm një shqetësim. Sot, duke ardhur me makinë, hasa në një gropë në rrugë. Kërkoj nga Drejtoria e Inspektoratit që të mbikëqyrë më nga afër punimet e ndërhyrjeve që po i kryen ujësjellësi. E dimë se rrjeti i ujësjellësit është i vjetruar dhe ndërhyrjet janë të domosdoshme. Mirëpo, pas përfundimit të punimeve, rrugët nuk po rikthehen në gjendjen e mëparshme. Mendoj se ky është një shqetësim për të gjithë ne. Duke filluar nga rruga "Bahri Kuçi" e deri në rrugën "Jeton Tërstena", si dhe në

shumë rrugë të tjera, pas ndërhyrjeve nuk po bëhet sanimi i duhur i dëmtimeve. E njëjta situatë po ndodh edhe pranë ekonomive familjare dhe objekteve banesore. Shpesh investohet në asfaltimin e një rruge të re, ndërsa pas vetëm dy ose tre javësh ajo rrugë prishet sërish për shkak të ndërhyrjeve dhe nuk rikthehet në gjendjen e mëparshme. Prandaj, kërkoj nga Drejtoria e Inspektoratit që të jetë më vigjilente në këtë aspekt dhe të sigurojë që, pas çdo ndërhyrjeje, rrugët të sanohen dhe të rikthehen në gjendjen e tyre fillestare.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- pasi i përshëndeti të pranishmit, deklaroi: po filloj me pyetjen e parë që e ngriti anëtari i kuvendit z. Refik Maloku, lidhur me bimët e mbjella në parkun e qytetit. Dua t'ju njoftoj se kemi hapur dy puse në parkun e qytetit. Fatkeqësisht, pusi i parë nuk ka pas ujë. Ndërsa pusi i dytë, pas gërmimit në një thellësi mbi 100 metra, ka siguruar ujë. Aktualisht është duke u instaluar sistemi i ujitjes, njësoj siç është instaluar edhe në rrethërrotullime, në mënyrë që të mos ketë probleme me mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra. Sa i përket mbjelljes së shpeshtë të disa bimëve, ato janë mbjellë përreth teqesë sepse hapësira përreth parkut do të shfrytëzohet edhe për lojërat e fëmijëve dhe besoj se, pas përfundimit të të gjitha punimeve, do të kemi një park shumë funksional dhe të bukur. Ka mbetur edhe një pjesë e murit që duhet të rregullohet për të zbutur pamjen e betonit në atë zonë. Pajtohem se disa bimë janë tharë. Megjithatë, kompania kontraktuese e ka ende përgjegjësinë për mirëmbajtjen dhe ujitjen e tyre. Në rast se ndonjëra prej tyre thahet, ajo do të zëvendësohet me të re. Natyrisht, është e dhimbshme të shohësh që edhe një bimë të thahet. Sa i përket shqetësimeve që i ngriti znj. Gresa Muli, ne kemi reaguar menjëherë. Ndoshta e keni parë edhe në rrjetet sociale. Megjithatë, nuk kam preferuar të bëj shumë publikime, sepse mendoj se gjuha e komunikimit në rrjetet sociale është degraduar ndjeshëm. Është krijuar një klimë e acaruar dhe besoj se të gjithë duhet të kontribuojmë për ta përmirësuar atë, jo vetëm ne që jemi këtu, por e gjithë shoqëria. Fatkeqësisht, po përdoret një gjuhë shumë fyese dhe helmuese. Për çdo rast që paraqitet ka komente nga njerëz që e njohin fushën, por edhe nga të tjerë që nuk kanë njohuri, megjithatë ofendojnë dhe gjykojnë pa bazë. Ne kemi qenë vazhdimisht në kontakt me organet e rendit. Epilogu i rastit tashmë dihet, ashtu si edhe vendimi që ka marrë Komuna e Vushtrrisë, në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat që ka. Personi është larguar nga puna, është arrestuar dhe tashmë rasti ndodhet në duart e organeve të drejtësisë. Megjithatë, më duket se mediat dhe rrjetet sociale po e rëndojnë edhe më shumë gjendjen duke e ngarkuar opinionin publik me përmbajtje negative. Besoj se kemi obligim që qytetarëve t'u ofrojmë edhe lajme pozitive, të promovojmë shembuj të mirë dhe të kontribuojmë në krijimin e një klime më të shëndetshme në shoqëri. Sa i përket investimeve në fshatin Sfaraçak, nuk mund të them se nuk është investuar fare, por as se janë përmbushur të gjitha nevojat. Ka pasur investime, megjithatë pranoj se i kemi mbetur borxh këtij fshati. Sfaraçaku është një ndër fshatrat me shtrirjen më të madhe territoriale dhe me vendbanime të shpërndara. Kemi investuar në rrjetin e kanalizimit, i cili më parë nuk ka ekzistuar fare, kemi zgjeruar rrjetin e ujësjellësit dhe kemi investuar edhe në ndriçimin publik gjatë mandatit tim. Megjithatë, pranoj se kemi mbetur borxh për ndërtimin e trotuarit. Një ndër arsyet kryesore ka qenë mungesa e mjeteve financiare, e shkaktuar edhe nga detyrimet që kanë rrjedhur nga kontrata kolektive. Kjo situatë ka ndikuar dukshëm në realizimin e projekteve, deri në atë masë sa u kemi mbetur borxh edhe operatorëve ekonomikë, të cilët për këtë arsye nuk kanë mundur t'i përfundojnë punimet sipas planifikimit. Sa u përket bursave për studentë, edhe kjo çështje lidhet me mungesën e mjeteve buxhetore. E dimë afatin kur është dashur të realizohen, mirëpo për shkak të kufizimeve financiare nuk kemi pasur mundësi t'i ndajmë mjetet e planifikuara. Sa i përket raportit të auditorit, ju ftoj ta lexoni me kujdes. Përveç çështjes së pagesave nga kode të ndryshme buxhetore, e cila ka ndikuar që raporti të jetë i kualifikuar, nuk ka gjetje të theksuara. Nëse do të kishte parregullsi të tjera me rëndësi, ato do të ishin evidentuar në

raport. Për rastin konkret që është përmendur, po ju them sinqerisht se nuk kam qenë në dijeni, por do të merrem personalisht me të. shqetësimi që ngrite anëtari i kuvendit z. Ramadan Parduzi është plotësisht me vend. Ai është shqetësim i yti, i të gjithë anëtarëve të Kuvendit edhe i imi. Sa i përket klubit të futbollit, nuk jemi ndalur së investuari. Aktualisht është duke u rregulluar stadiumi në Dobërllukë, me qëllim që të shërbejë si stadium ndihmës për zhvillimin e stërvitjeve dhe ndeshjeve. Atje janë realizuar punime të konsiderueshme. Sa u përket pagave të lojtarëve, përgjegjësia u takon kryesisë së klubit dhe sponsorëve. Nga ana e komunës kemi vepruar në kuadër të kompetencave ligjore. Pas inkuadrimit të klubit në Super Ligë, kam marrë vendim që secili lojtar të mbështetet financiarisht nga komuna. Menjëherë kam nxjerrë vendimet dhe secili lojtar ka përfituar nga 1.000 euro. Po dua të jem plotësisht transparent me ju. Nuk e kam marrë këtë vendim para ndeshjes, edhe pse e dija se lojtarëve u ishin vonuar pagat. Nuk kam dashur që para ndeshjes t'u them: "Dilni dhe fitoni, sepse do të merrni këtë mbështetje financiare." Kam preferuar që vendimin ta zbatoj pasi e përfunduan me sukses garën. Më pas i kam thirrur dhe ua kam shpjeguar arsyet pse nuk e kam bërë më herët. Sikur t'i kishin marrë të gjitha pagat me kohë, do të kishim vepruar ndryshe. Sa i përket informatës së z. Berat Sadiku që ngrite, ajo nuk është e saktë. Segmenti rrugor nga vendi ku ndahet autostrada, tek Nadakovci, përgjatë Vushtrrisë deri në Smrekonicë, është pronë e ministrisë dhe menaxhohet nga ajo ministri. Komuna ka dërguar dy kërkesa zyrtare me shkrim që ky segment t'i bartet në menaxhim. Më herët kjo ka qenë më e vështirë, pasi nuk ka pasur rrugë alternative. Tani, me përfundimin e autostradës deri në Smrekonicë, ekziston mundësia që kjo përgjegjësi t'i kalojë komunës. Në emër të Komunës së Vushtrrisë shpreh edhe një herë ngushëllimet më të sinqerta për familjen e viktimës. Edhe unë personalisht jam prekur shumë nga ai rast tragjik dhe besoj se secili prej nesh e ka përjetuar rëndë. Fatkeqësisht, nuk ka qenë rasti i vetëm në atë segment rrugor. Po e them publikisht: në momentin që ministria na e bart këtë rrugë në pronësi dhe menaxhim, do të ndërtojmë rrethrrotullime në ato udhëkryqe. Besoj se kjo është zgjidhja më e mirë dhe më e sigurt, shumë më efektive sesa semaforët, të cilët shpeshherë nuk funksionojnë si duhet. Nëse është e nevojshme, kërkesat zyrtare që kemi dërguar mund t'i publikojmë edhe në faqen zyrtare të komunës, në mënyrë që çdo qytetar të bindet se Komuna e Vushtrrisë ka ndërmarrë të gjitha veprimet që i takojnë. Nuk kam dëshirë të merrem me akuza dhe kundër akuza. Problemet nuk zgjidhen me deklarata, por me punë konkrete. Prandaj, do të kërkoj edhe një takim të drejtpërdrejtë me ministrin, për t'ia paraqitur edhe njëherë këtë kërkesë. Nëse rruga na bartet në menaxhim, komuna do ta marrë përgjegjësinë e plotë për investimet dhe mirëmbajtjen e saj. z. Ymer Haradinaj, të falënderoj për kontributin tënd në lidhje me atë objekt. Ke qenë shumë këmbëngulës që në mandatin para këtij, jo në mandatin tim, që ai objekt të kthehet në çerdhe, pra t'u kthehej nxënësve. E ke pasur mbështetjen tonë dhe, objekti tashmë u është kthyer nxënësve. Sa i përket renovimit të tij, në atë kohë kemi pasur mjete dhe mundësi vetëm për të ndërhyrë pjesërisht, me qëllim që t'u përgjigjeshim kërkesave të qytetarëve dhe të fillonim punimet në përputhje me mundësitë që kishim. Megjithatë, mbetet ende shumë punë për t'u bërë, pasi objekti duhet të rinovohet tërësisht. Me planifikimin e buxhetit për vitin 2027 do ta analizojmë këtë projekt dhe do ta përfshijmë në buxhet, në mënyrë që renovimi të përfundojë plotësisht. Sa i përket kanalizimit, përkatësisht kolektorit kryesor, projekti tashmë është hartuar. Është e vërtetë se ai kalon nëpër shtratin e lumit dhe jemi të vetëdijshëm për problemet që janë krijuar. Kam qenë personalisht disa herë në terren dhe kam vizituar familjet që preken drejtpërdrejt nga kjo çështje. Ju siguroj se edhe ky problem do të zgjidhet. Kjo përfshin edhe Stanocin e Ulët dhe zonat e tjera që preken nga ky kolektor. Sa i përket rrugëve që i përmendët, ato janë përgatitur për asfaltim. Bëhet fjalë për rrugën prej Lumit të Madh deri në Stanoc të Ulët, si dhe për rrugën në Lagjen e Muhaxherëve. Në këtë të fundit kemi bërë zgjerimin e rrugës nga 3

metra në 5 metra, pasi ishte shumë e ngushtë dhe i shërben një numri të madh banorësh. Megjithatë, problemi vazhdon të jetë tek operatorët ekonomikë. Dje kam komunikuar me menaxherin e projektit dhe më është konfirmuar se punimet për asfaltim do të fillojnë javën e ardhshme. Edhe operatorët janë përballur me vështirësi për shkak të rritjes së çmimit të naftës dhe mungesës së mjeteve financiare, pasi komuna u ka mbetur borxh për një pjesë të punëve të kryera. U kam kërkuar që punimet t'i përfundojnë, ndërsa obligimet financiare do t'i shlyejmë gjatë vitit të ardhshëm, sepse nuk mund të planifikojmë shpenzime përtej mundësive buxhetore dhe duhet të kemi parasysh edhe borxhet ekzistuese. Sa i përket rrugëve "Bekim Berisha" dhe "Isak Halili", projekti për rrugën "Isak Halili" është hartuar dhe ajo do të ndërtohet sipas të njëjtit standard si rruga "Lumni Surdulli". Pjesa që është përmendur nuk është përfunduar ende, prandaj edhe është në atë gjendje. Rruga "Isak Halili" do të realizohet me të njëjtin standard si rruga "Lumni Surdulli", ashtu siç është planifikuar. Ndërsa për rrugën në Sllatinë, keni plotësisht të drejtë. E di saktësisht për cilin vend bëhet fjalë. Aty kanë intervenuar ekipet e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit. Komuna është munduar t'i dalë në mbështetje kësaj kompanie, në mënyrë që qytetarët të marrin shërbimet e nevojshme, pasi kompania nuk ka kapacitete t'i rikthejë rrugët në gjendjen e mëparshme. Për këtë arsye kemi marrë përsipër që, pasi të përfundojnë punimet, asfaltimin ta kryejë komuna. Megjithatë, gropa është dashur të mbyllej dhe të mos lihej në atë gjendje. I kërkoj drejtorit që të dalë urgjentisht në terren, sepse edhe dje mora një ankesë nga një qytetar për këtë problem. Sa i përket vendosjes së pengesave në rrugë, ka shumë kërkesa nga qytetarët. Megjithatë, duhet të ndryshojmë rregulloren dhe ta rikthejmë atë në Kuvend, pasi çmimi aktual është shumë i ulët. Nuk mund të kërkohet që operatorët ekonomikë të ndërhyjnë për prerje dhe asfaltim të sipërfaqeve shumë të vogla me të njëjtin çmim që aplikohet për shtrimin e asfaltit. Asnjë operator nuk pranon të kryejë punime për vetëm disa metra katrorë me çmimet aktuale. Kjo çështje duhet të rregullohet. Sa i përket rrugës "Bahri Kuqi", projekti është hartuar, pasi ajo lidhet me autostradën. Është paraparë që të ndërtohet sipas standardeve, me infrastrukturë nëntokësore, kabllim tokësor dhe ndriçim publik deri në qendër të fshatit Gojbul. Kështu është parashikuar në projekt.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- tha se, po ndërlidhem me deklarimin e kryetarit në lidhje me fshatin Sfaraçak, ku u tha se të gjitha punët në sistemin e ujësjellësit janë kryer gjatë këtij mandati. Dua të sqaroj se kjo nuk qëndron. Më kujtohet shumë mirë se Sfaraçaku ka qenë i inkorporuar në sistemin e ujësjellësit që para luftës. Pas luftës, gjatë mandatit tonë, është zgjeruar rrjeti edhe në një grup të ri të banorëve dhe është bërë lidhja e shumë lagjeve që deri atëherë nuk kanë qenë të kyçura në sistem. Sa i përket punëve që janë kryer në këtë mandat, aq sa kam njohuri, është bërë vetëm vendosja e një pompe, përkatësisht një ndërhyrje për rritjen e shtypjes së ujit. Të gjitha punët e tjera, përfshirë rrjetin dhe kyçjet individuale, janë realizuar më herët, gjatë mandatit tonë. Prandaj, nuk mund të thuhet se të gjitha punët në sistemin e ujësjellësit në fshatin Sfaraçak janë kryer në këtë mandat.

Benjamin Shala, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi: po ndërlidhem fillimisht me çështjen që e ngriti znj. Gresa, lidhur me trotuarin që ka mbetur i papërfunduar tash e dy vjet. Punimet kishin filluar sipas projektit, mirëpo në momentin kur përmbaruesi ka tërhequr mjetet financiare nga kodi buxhetor i këtij projekti, ato janë ndërprerë. Furnizimi ishte realizuar dhe materialet kishin mbërritur në vend punishte, por punimet nuk kanë mundur të vazhdojnë. Prandaj, do t'ju lutesha të gjithëve, si grupe parlamentare dhe si anëtarë të Kuvendit, që ta mbështesni komunën tek Ministria e Financave, në mënyrë që të na kthehen mjetet për investime kapitale. Nuk po kërkoj që të na kthehen të gjitha mjetet, por vetëm ato që u janë marrë projekteve të papërfunduara. Nëse këto mjete rikthehen, projektet do të përfundojnë dhe nuk

do të ketë asnjë pengesë tjetër. Sa i përket sistemit të ujësjellësit, dua të theksoj se, kur ju e morët përgjegjësinë për qeverisjen, në pjesët më të larta të fshatit Sfaraçak nuk kishte ujë. Përjashtim bënin vetëm ato zona që kishin furnizim me ujë që para luftës. Në asnjë pjesë tjetër nuk kishte furnizim të rregullt. Sot situata është ndryshe. Edhe pikat më të larta të fshatit Sfaraçak kanë furnizim me ujë.

Melihate Basholli- Latifi, kryesuese e kuvendit- me kaq po e përmbyllim pjesën e parë. Kalojmë tek pjesa e diskutimeve për rendin e ditës.

Benjamin Shala, Drejtor i Shërbimeve Publike- pas konsultimit javën e fundit me disa biznese, rreth kategorizimit të bizneseve, kemi parë që ka hapësira me diskutuar edhe këtë seancë e tërheqim nga diktimi Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 20 vota "për", 1 votë "kundër", aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 maj 2026;
2. Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2027-2029;
3. Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje për vitin 2025;
4. Propozim – vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 294/19, të datës 31.10.2019 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.
5. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 maj 2026;

Pas shqyrtimit, kuvendi pas votimit me vota "unanime" aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës së Vushtrrisë, mbajtur në datën 28 maj 2026.

2. Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2027-2029;

Melihate Basholli- Latifi, kryesuese e kuvendit- tha se Draft - Korniza Afatmesme për vitet 2027-2029 është diskutuar edhe në Komitetin për Politikë e Financa. Përveç kësaj e kemi dhe kalendarin për dëgjimet buxhetore. Anëtarët e KPF-së veç i kemi caktuar në vendet ku do të jemi, ndërsa ju anëtarë të tjerë të Kuvendit ju ftoj që posa ta merrni kalendarin të merrni pjesë në dëgjime buxhetore.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit vijoi: Korniza Afatmesme buxhetore 2027-2029 është dokumenti bazë për planifikimin e buxhetit komunal i cili përmban prioritete strategjike lidhur me caçet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve mbi bazën e të cilët planifikohet buxheti për vitin 2027 si dhe projeksioni për dy vitet e ardhshme 2028-2029. Nga dokumenti shihet se komunat pranojnë grante operative nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe ato janë: granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim dhe granti specifik për shëndetësi. Në vitin 2026 granti i përgjithshëm për komunën e Vushtrrisë është 12,210,626 euro kurse për vitin 2027 falë qeverisë Kurti ky grant rritet dhe arrin vlerën 13,366,922€. Tek granti specifik për arsim kemi rënie sigurisht për shkak të zvogëlimit

të numrit të nxënësve. Pra nga viti 2026 në vitin 2027 kemi një rënie të lehtë. Kurse granti për shëndetësi në vitin 2026 e ka vlerën 3,062,052€ kurse për vitin 2027 edhe ky grant ka rritje të vlerës në 3,231,203€ . Në tërësi vlera e granteve në komunën tonë në vitin 2027 është 27,731,331 € kurse buxheti i përgjithshëm për vitin 2026 ka qenë afër 30 milion, ndërsa për vitin 2027 ky buxhet do të ketë rritje dhe ka vlerën 31,683,408 €. Korniza Afatmesme Buxhetore është një dokument financiar që duhet të paraqesë vizionin e komunës, menaxhimin e përgjithshëm të financave publike dhe ofrim të shërbimeve cilësore që në rastin e komunës sonë po mungon. Përmes këtij dokumenti do të duhej të krijohej një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet kërkesave të qytetarëve, prioriteteve strategjike komunale dhe mundësive reale financiare, duke siguruar që çdo euro e buxhetit komunal të shfrytëzohet në mënyrë sa më efikase dhe me ndikim sa më të madh në jetën e qytetarëve që në rastin e komunës sonë nuk po ndodh. Nga ajo që po shihet dhe po dëgjojmë edhe sot nga paraqitjet publike të kryetarit të komunës sonë, komuna e Vushtrrisë nuk ka buxhet të qëndrueshëm financiar, nuk ka bërë planifikim realist dhe nuk ka orientuar investimet publike drejt sektorëve me ndikim më të madh në zhvillimin ekonomik dhe social të komunës sonë. Korniza Afatmesme Buxhetore dhe takimet buxhetore me qytetarë do të duhej të mundësonin përfshirjen aktive të qytetarëve në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, harmonizimin e projekteve me kapacitetet financiare, dhe të siguroj që projektet të jenë të mbështetura në burime reale financiare. Do të duhej të ketë tregues që dëshmojnë për nevojën e vazhdueshme të investimeve në infrastrukturë, në arsim, në shëndetësi, mjedis dhe në zhvillim ekonomik lokal. Sa i përket arsimit për vitin 2027, kërkojmë nga komuna që të kemi arsim më cilësor, përmirësim të infrastrukturës shkollore, investime në pajisje dhe teknologji dhe krijimit të kushteve më të mira për nxënës dhe mësimdhënës. Sa i përket shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, kërkojmë të bëhet modernizimi i objekteve shëndetësore, përmirësimi i shërbimeve për qytetarët dhe mbështetja e kategorive sociale në nevojë. Kurse tek infrastruktura dhe mjedisi kërkojmë të bëhet ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve, zgjerimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe projekte të cilat ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit- pasi përshëndeti të pranishmit, vijoi: u bë një kohë e gjatë që po vërejmë se dëgjimet buxhetore po karakterizohen nga pjesëmarrje e ulët, madje në disa raste po shkojnë drejt dështimit. Mendoj se kjo është një çështje shqetësuese, e cila vjen si pasojë e një arsyeje të caktuar, e ajo është mos përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Kjo nuk është një dukuri që lidhet vetëm me qeverisjen aktuale, por ka qenë e pranishme tash e 26 vjet. Dua të ndaj një praktikë që e kemi zbatuar gjatë periudhës 2017–2021, lidhur me orientimin e kategorive, përkatësisht shtyllave buxhetore të komunës. Atëherë kemi realizuar një anketë online për qytetarët dhe rekomandoj që një praktikë e tillë të zbatohet edhe tani. Jemi në vitin 2026, teknologjia po avancon vazhdimisht dhe jeta është bërë më dinamike. Ndoshta qytetarët, përveç se nuk po ndihen të përfshirë në procesin e vendimmarrjes dhe në adresimin e kërkesave të lagjeve apo fshatrave të tyre, do ta kishin më të lehtë të japin propozimet përmes një ankete online, duke shprehur mendimin se në cilat fusha duhet të orientohet buxheti komunal për vitin 2027, qoftë në ekonomi, shëndetësi, arsim, kulturë, shërbime publike apo në sektorë të tjerë. Pse të mos krijohet edhe një mundësi shtesë, ku qytetarët të kenë rastin të paraqesin nevojat dhe kërkesat e tyre lokale, që kanë të bëjnë me lagjet, fshatrat apo rrugët e qytetit tonë? Për mua, si ekonomist, aspekti socio-ekonomik mbetet veçanërisht shqetësues. Mendoj se do të ishte e nevojshme që së bashku të themelonim një ekip pune ose një komision, me mandat për tre vitet e ardhshme, i cili do të analizonte në vazhdimësi të gjitha çështjet dhe ankesat që ndërlidhen me gjendjen socio-ekonomike të qytetarëve. Ju e dini se, përveç detyrës sime si anëtar i Kuvendit Komunal, ushtroj

edhe një përgjegjësi tjetër, ku çdo ditë ballafaqohem me gjendjen socio-ekonomike të qytetarëve. Fatkeqësisht, rajoni ynë renditet ndër pesë komunat me gjendjen më të rëndë ekonomike dhe me numrin më të madh të përfituesve të asistencës sociale. Ky komision do të mund të trajtonte, muaj pas muaji, të gjitha ankesat dhe nevojat e evidentuara, duke analizuar se çfarë mund të mbështetet realisht nga buxheti komunal, me qëllim që familjeve në nevojë t'u sigurohen së paku shërbimet bazike dhe të lehtësohet gjendja e tyre ekonomike. Këto ishin dy propozimet e mia. Së pari, procesi i dëgjimeve buxhetore të shoqërohet edhe me një anketë online, e cila mund të realizohet lehtësisht në bashkëpunim me Zyrën e IT-së. Së dyti, aspekti socio-ekonomik të ketë një vend më të rëndësishëm në planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2027.

Isuf Jashari-Drejtor për Buxhet dhe Financa- pasi përshëndeti të pranishmit, në adresimin e tij para kuvendit vijoi: sikurse çdo vit, edhe këtë vit, në bazë të Qarkores Buxhetore Nr. 01/2027, jemi të obliguar të hartojmë dhe propozojmë Dokumentin Strategjik, i cili shërben si bazë për planifikimin e buxhetit për periudhën 2027–2029. Në kuadër të këtij dokumenti kemi përgatitur një analizë të detajuar, e cila është në dispozicion të komunës dhe përfshin planifikimin e të hyrave dhe të shpenzimeve si dhe projeksionet për dy vitet pasuese, përkatësisht 2027-2029. Bazuar në kërkesat që kemi pranuar, është e pamundur që të gjitha të përfshihen brenda kufijve buxhetorë në dispozicion. Për këtë arsye, kemi bërë një planifikim të përgjithshëm të programit buxhetor, duke u mbështetur në kategoritë ekonomike dhe në kufijtë e grantit të përcaktuar me Qarkoren Buxhetore nr. 01/2027. Pas këtij hapi do të publikohet edhe Qarkorja Buxhetore nr. 02, me të cilën do të specifikohen kategoritë ekonomike, përkatësisht pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet, si dhe investimet kapitale. Qëllimi ynë është që buxheti të shpërndahet në mënyrë të drejtë ndërmjet këtyre kategorive ekonomike dhe, në këtë mënyrë, të harmonizohen sa më mirë kërkesat e paraqitura me mundësitë buxhetore. Prioriteti ynë fillestar do të jetë shlyerja e obligimeve të papaguara. Më pas, mjetet e mbetura do të orientohen drejt projekteve më emergjente dhe atyre që kanë ndikimin më të madh për qytetarët. Kjo do të realizohet në bashkëpunim dhe konsultim me Kuvendin Komunal dhe ekzekutivin, me qëllim të hartimit të një plani buxhetor sa më të balancuar dhe funksional.

Në fund të debatit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 16 vota "për", 6 vota "kundër", vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2027/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2027-2029.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029 e Komunës së Vushtrrisë.

3. Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje për vitin 2025;

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- fillimisht, dëshiroj t'ju njoftoj se edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa kam kërkuar material shtesë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, pasi materiali i ofruar është tepër i mangët dhe informacioni nuk është i detajuar. Tema e trajtuar në këtë pikë lidhet me procedurën e legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje për vitin 2025. Në këtë drejtim, kam disa paqartësi dhe vërejtje. Së pari, nëse flasim për legalizimin e objekteve të

ndërtuara në vitin 2025, atëherë shtrohet pyetja se cila është arsyeja që qytetarët të aplikojnë për leje ndërtimi, kur ekziston perceptimi se çdo vit po realizohet procesi i legalizimit. Për këtë arsye, konsideroj se edhe vetë titulli i materialit është i pasaktë dhe i paqartë. Sa i përket statistikave të Drejtorisë së Urbanizmit, aty paraqiten kërkesa të aprovuara, në shqyrtim dhe të refuzuara, për kategori të ndryshme. Megjithatë, kam kërkuar që të na ofrohet një informacion më i detajuar. Drejtor, edhe pse nuk keni qenë i pranishëm në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, besoj se përmes sekretarisë së kuvendit, jeni njoftuar me shkrim lidhur me kërkesën time për sqarim shtesë: cilat janë objektet e kategorisë së parë dhe të dytë që parashihet të legalizohen, si dhe cili është afati kohor i procesit të legalizimit, përkatësisht deri në cilin vit përfshihen objektet. Në këtë material po krijohet përshtypja se po përfshihen edhe objektet e ndërtuara në vitin 2025, gjë që nëse është e saktë, atëherë bie logjika e aplikimit për leje ndërtimi, pasi qytetarët do të konsideronin se ndërtimi pa leje legalizohen automatikisht në të ardhmen. Prandaj, kam kërkuar që informacioni të detajohet dhe të qartësohet, sepse aktualisht është i paqartë dhe i mangët. Gjithashtu, konsideroj se materiale të tilla duhet të jenë të përgatitura në formë të shkruar dhe të dorëzuara me kohë, pasi ne kemi dy mbledhje në muaj dhe duhet të kemi informacion të plotë për të marrë vendime të duhura.

Drilon Jusufi- drejtor i DUMM-së- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi: Sa i përket çështjes së legalizimeve për vitin 2025, sqaroj se bëhet fjalë për kërkesat e trajtuara gjatë këtij viti. Legalizimi i objekteve pa leje mund të bëhet vetëm për objektet të cilat, sipas ortofotos, rezultojnë të jenë ndërtuar deri në vitin 2018. Pra, përfshihen objektet që shihen në ortofoton e vitit 2018 dhe më herët, përkatësisht objektet e ndërtuara që nga periudha pasluftës e deri në atë vit. Pyetja ka qenë se cilat objekte janë trajtuar gjatë vitit 2025. Në këtë periudhë kemi pasur gjithsej 98 kërkesa për legalizim. Prej tyre, 8 kërkesa kanë qenë të kategorisë së dytë. Kategoria e dytë përfshin objektet mbi 450 m², si dhe disa kritere të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Ndërsa kategoria e parë përfshin objektet banimore dhe afariste, përkatësisht të gjitha objektet që janë nën 450 m². Sa i përket pyetjes se cilat objekte janë pa leje ndërtimi, duhet theksuar se nuk ka një evidencë të plotë të të gjitha objekteve pa leje, pasi që nga periudha e pasluftës janë ndërtuar shumë objekte në të gjithë territorin e Kosovës, të cilat ende nuk janë evidentuar në mënyrë të plotë. Lidhur me pyetjen se cilat objekte do të legalizohen, aktualisht nuk mund të jepet një listë e saktë, pasi procesi varet nga përmbushja e kritereve ligjore nga aplikuesit. Gjithashtu, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e ka zgjatur afatin për aplikim për legalizim deri në fund të vitit 2026. Fillimisht afati ka qenë deri në fund të dhjetorit 2025, por është shtyrë me vendim të ministrisë dhe aktualisht është i vlefshëm deri në fund të vitit 2026. Nuk dihet ende nëse ky afat do të vazhdohet më tej. Sa i përket klasifikimit të objekteve, nga 98 kërkesat e pranuara gjatë vitit 2025, 90 janë të kategorisë së parë, ndërsa 8 janë të kategorisë së dytë. Të aprovuara prej tyre janë 50. Ndërsa në listë pritjeje janë 30, pasi nuk i kanë plotësuar kriteret e nevojshme, disa prej të cilave kanë dalë jashtë vijës ndërtimore dhe nuk përmbushin kushtet për legalizim. Dy kërkesa janë refuzuar, dy janë të përsëritura, ndërsa 14 kërkesa janë ende në proces të shqyrtimit.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit- tha se Vushtrria është një vend mjaft specifik në Kosovë. Të gjithë krenohemi me historinë e Vushtrrisë. Mendoj se kemi disa arkitektë dhe profesionistë të fushës, të cilët duhet të japin një kontribut më të madh, veçanërisht gjenerata e re dhe ata që janë të angazhuar në proceset vendimmarrëse. Si ekonomist, nuk e kam plotësisht të qartë çështjen e afatit të zgjatur për legalizim deri në fund të vitit 2026. A nënkupton kjo që të gjitha ndërtimet e realizuara deri në këtë periudhë do të legalizohen automatikisht? Kjo është pyetja ime. Gjithashtu, nëse ka vendime që janë refuzuar, do të ishte e rëndësishme të sqarohen arsyet e refuzimit, në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë të procesit. Mendoj se është shumë e rëndësishme dhe e dobishme që të kemi një informatë të përgjithshme dhe të saktë për numrin e përafërt të objekteve apo ndërtimeve pa leje që ekzistojnë në komunën tonë. Natyrisht, informacioni nga inspektorati është i domosdoshëm, por do të ishte e nevojshme një bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet drejtorisë së

Urbanizmit dhe Drejtorisë së Inspektimeve, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të plotë dhe të saktë të gjendjes në terren, përfshirë të gjitha të dhënat dhe format e evidentimit që disponohen. **Drilon Jusufi- drejtor i DUMM-së-** siç u tha edhe nga Kryesuesja e Kuvendit, objektet të cilat janë ndërtuar deri në vitin 2018 mund të legalizohen, por vetëm nëse i plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore. Ndër kriteret kryesore është që objekti të jetë brenda parcelës përkatëse, si dhe të përmbushë edhe kriteret e tjera të parapara me legjislacionin në fuqi. Kushti kryesor është që objekti të mos e tejkalojë parcelën ndërtimore. Natyrisht, ekzistojnë edhe kritere të tjera të cilat duhet të plotësohen në procesin e legalizimit. Ky vendim është i Ministrisë përkatëse dhe vlen për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, jo vetëm për një komunë të caktuar. Është një vendim që është miratuar më herët dhe ka qenë në fuqi edhe në periudhat paraprake.

4. Propozim – vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 294/19, të datës 31.10.2019 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- konsideroj se është e rëndësishme që në rastet e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, siç ishte rasti i fundit me spitalin, të vendosen afate të qarta dhe të përcaktuara kohore. Në përgjithësi, është praktikë e mirë që toka komunale, kur jepet për investime të ndryshme, të shoqërohet me afate të përcaktuara, në mënyrë që në rast se projekti i paraparë nuk realizohet, prona t'i kthehet sërish komunës. Në këtë drejtim, si Lëvizje Vetëvendosje, e përkrahim këtë vendim.
Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- tha se ka deklaruar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, siç e tha edhe shefi i grupit se ne e kemi përkrahur këtë vendim. Megjithatë, dëshiroj të shtoj edhe disa sqarime shtesë. Në mandatin e kaluar kemi qenë pjesë e një komisioni që ka punuar në verifikimin e dhënies së pronave komunale në një periudhë të caktuar. Në atë kohë, projekti në fjalë ka qenë i planifikuar për t'u realizuar në vitet 2019–2021, por nuk është realizuar për shkak të paraqitjes së pandemisë COVID-19, pastaj edhe luftës mes Rusisë dhe Ukrainës. Si anëtar i atij komisioni, së bashku me Agron Përçuku, Bekim Zabërgja, Zojë Hajrizi, si dhe përfaqësuesit e kompanisë investuese, kemi zhvilluar takime dhe diskutime lidhur me këtë projekt. Në ato takime, përfaqësuesit e kompanisë e kanë pranuar se projekti nuk do të realizohej dhe është arritur dakordim për tërheqjen nga investimi. Më pas, kjo është raportuar edhe në Kuvend, përmes procesverbaleve dhe dokumenteve zyrtare, ku është evidentuar se palët kanë pranuar ndërprerjen e projektit dhe janë tërhequr nga marrëveshja. Në këtë mënyrë është arritur një marrëveshje e ndërsjellë dhe me mirëkuptim, ku është shmangur mundësia e padive reciproke, si nga ana e kompanisë ndaj komunës, ashtu edhe nga ana e komunës ndaj kompanisë, duke marrë parasysh që të dyja palët kishin mosrealizim të disa obligimeve kontraktuale. Prandaj, konsideroj se ky është një rast i zgjidhur me mirëkuptim, dhe prona e mbetur përbën një vlerë të shtuar për komunën tonë.

Në fund të debatit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 23 vota "për", 1 votë "kundër", vendosi me sa vijon:

1. Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë nr. 294/19, datë 31.10.2019, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale – parcela kadastrale P-70202022-00512-1, ZK-Gracë, në sipërfaqe prej 53693 m².

2. Shfuqizimi i Vendimit të cekur në piken 1 të këtij Vendimi, bëhet duke u bazuar në mos realizimin e kontratës:

2.1. Investimi i paraparë nuk është realizuar;

2.2. Prona komunale nuk është vënë në funksion sipas destinimit të miratuar;

2.3. Nuk janë përmbushur obligimet esenciale të përcaktuara me kontratë;

2.4. Nuk është realizuar interesi publik dhe ekonomik për të cilin është dhënë prona komunale në shfrytëzim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

4. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi-shfuqizohet çdo akt që ka derivuar nga ky Vendim.

5. Pyetje dhe përgjigje.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- pyetja ime i drejtohet Drejtorit të Financave, i cili nuk është i pranishëm në këtë pjesë të mbledhjes, dhe ka të bëjë me disa paqartësi në projekt buxhetin për vitin 2027. Së pari, dëshiroj të pyes pse në projekt buxhetin për vitin 2027 janë planifikuar më pak të hyra vetanake krahasuar me vitin 2026. Sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe raportit financiar në dispozicion, në vitin 2026 janë planifikuar të hyra vetanake në vlerë prej 4,403,052 euro, ndërsa në vitin 2027 janë planifikuar 3,952,154 euro, që paraqet një rënie prej mbi gjysmë milioni euro. Cila është arsyeja e kësaj uljeje në planifikim? Pyetja e dytë lidhet gjithashtu me Drejtorinë e Financave. Në vazhdimësi, si drejtori ashtu edhe kryetari i komunës kanë theksuar mungesën e mjeteve financiare. Megjithatë, dëshiroj të pyes pse në vitin 2025 komunës i kanë mbetur mjete të pashpenzuara në vlerë prej mbi 500,000 euro, të cilat janë bartur në vitin 2026. Pse këto mjete nuk janë shfrytëzuar gjatë vitit 2025?
Betim Grabanica, anëtar i kuvendit- Kam tre pyetje për Drejtorin e Shëndetësisë. Së pari, kërkoj të na njoftohet se çfarë është duke ndodhur me shërbimet mjekësore dhe bashkëpunimet me institucionet relevante, përkatësisht lidhur me ofrimin dhe funksionimin e këtyre shërbimeve. Së dyti, kërkoj të na informoni se sa janë borxhet e Komunës ndaj Bashkësisë Islame lidhur me shërbimet e varrezave. Së treti, kërkoj të na jepet informacion se sa janë borxhet e Komunës ndaj organizatës së z. Halil Kastrati për ndërtimin e shtëpive dhe qendrave të banimit. Do të doja që këto informata të na ofrohen të shkruara për seancën e ardhshme.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit